

Intervistë/Ambasadori i OSBE-së: Është e rrezikshme të përmendësh termat “etnikisht e pastër”

Vacek: Marrëveshje urgjente për listat

“Harta Zgjedhore, jam optimist për konsensusin”

Blerina Gjoka

Ambasadori i OSBE-së në Tiranë, Pavel Vacek, në një intervistë dhënë për Gazeta Shqiptare shprehet se është optimist se shumë shpejt partitë do të arrijnë një marrëveshje për zonat zgjedhore. Por Vacek tregon se shumë shpejt do të haste një tjetër prolem, “listat zgjedhore”. Ai këshillon që urgjentisht të bëhet një marrëveshje lidhur me përgatitjen e listave të përmirësuara në mënyrë të ndjeshme. Kjo ka qenë një prej kërkesave kryesore të OSBE/ODIHR-it dhe rekomandimet përkatëse mbeten ende për t’u zbatuar”.

Për zonat minoritare ai quan të rrezikshëm etiketimet “etnikisht të pastër”, të kujton ish-Jugosllavinë, shpjegon Vacek, i cili shton se “standartet ndërkombëtare lejojnë përjashtime nga rregullat e përgjithshme për zonat zgjedhore, kur një gjë e tillë justifikohet nga interesat e një pakice”. Dhe pakica në këtë rast është minoriteti grek në disa zona të jugut të vendit.

1. Z. Ambasador, ndarja e re e zonave zgjedhore në Shqipëri tregoi edhe një herë se politika shqiptare nuk po arrin të gjejë një gjuhë të konsensusit. Afati i parashikuar në marrëveshje për të negociuar ka mbaruar. A do të ndër marrë OSBE-ja iniciativa të reja për të negociuar sërish me partitë politike për gjetjen e konsensusit përfundimtar?

Ka qenë e qartë që nga data 5 shkurt se anëtarët e Grupit të Ekspertëve të mbështetur nga Prezenca e OSBE-se dhe Këshilli i Evropës nuk mund të binin dakord mbi formulën e propozuar nga Kryetari i Grupit, e cila i përmbushte më mirë kërkesat ligjore. Kuvendi është vënë në dijeni të pamundësisë së arritjes së një zgjidhjeje që do të përmbushte plotësisht të gjitha kërkesat ligjore. Që nga ajo kohë, ne kemi qenë në kërkim të një kompromisi politik, që do të ishte shumë më larg ideale sesa ai i propozuar nga Kryetari i Grupit. Kontaktet e fundit jozyrtare na japin shpresë se partitë politike do të mund të bien dakort për një kompromis, por kjo do të kërkojë ende përpjekje të tjera.

2. Cili do të jetë roli i mëtejshëm i OSBE-së në procesin e përgatitjes së zgjedhjeve deri në zhvillimin e tyre?

Prezenca e OSBE-së është e gatshme të ndihmojë institucionet shqiptare në të gjitha përgatitjet për zgjedhjet. Roli ynë në mbështetjen e legjislacionit zgjedhor është i njohur dhe është përmendur tashmë. Mbështetja më e madhe është dhënë për regjistrimin e zgjedhësve, falë projektit prej 800.000 Euro financuar nga Komisioni Evropian. Në këtë kuadër, ne kemi bashkëpunuar nga afër me Ministrinë e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit për listat e zgjedhësve dhe me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për çështje si trajnimi i administratës

zgjedhore dhe përzgjedhja e vendeve të duhura për zhvillimin e proceseve të votimit dhe numërimit. Përveç kësaj, ne vazhdojmë të sigurojmë këshillim teknik për interpretimin dhe zbatimin e Kodit të ri Zgjedhor.

3. Z. Vacek, sa të rëndësishme i konsideroni zgjedhjet e ardhshme për të ardhmen e vendit tonë?

Nuk do të doja ta ktheja këtë në klishe, por këto zgjedhje janë një test. Përfundimisht, Shqipëria duhet të jetë në gjendje të zhvillojë zgjedhje që plotësojnë standardet ndërkombëtare, që organizohen në mënyrë të rregullt e profesionale, e që vendosen vetëm nga zgjedhësit dhe jo nga manipulimet.

4. Termi “etnikisht i pastër”, i përdorur nga politikanët, sa i saktë është, duke iu referuar propozimit për krijimin e një zone zgjedhore në jug të vendit, e cila bazohet në shumicë nga minoriteti grek?

Pikësëpari, përdorimi i një nocioni të tillë, që ka ngjyrimë jo të mira nisur nga tragjedia e ish-Jugosllavisë, nuk është me vend, madje është keqdashës në këtë debat dhe duhet të shmanget. Procesi i rindarjes së zonave zgjedhore nuk ndihmohet apo thjeshtohet aspak përmes përdorimit të një gjuhe të tillë manipuluese. Janë diskutuar disa variante në lidhje me rindarjen zgjedhore të zonës së banuar nga pakica greke dhe, tashmë, sfida mbetet tek përzgjedhja e një varianti që është në përputhje me standardet ndërkombëtare, si dhe i pranueshëm për partitë politike shqiptare. Ajo që mbetet e padiskutueshme është se standardet ndërkombëtare lejojnë përjashtime nga rregullat e përgjithshme për zonat zgjedhore, kur një gjë e tillë justifikohet nga interesat e një pakice.

5. Cilat janë çështjet për të cilat duhet të arrihet konsensusi mes partive politike shqiptare në lidhje me procesin zgjedhor?

Para së gjithash, është e nevojshme që partitë politike të bien dakort më në fund për rindarjen e zonave zgjedhore. Kohë e çmuar për përgatitjet zgjedhore është humbur me çdo ditë shtesë të shpenzuar me debate partiake për këtë çështje – kjo po vë në rrezik vazhdimin e përgatitjeve zgjedhore. Aftësia për të arritur një kompromis të shpejtë dhe të arsyeshëm midis partive kryesore politike për këtë çështje është sfida më imediate për përfaqësuesit politikë shqiptarë.

Përveç kësaj, një marrëveshje midis institucioneve përgjegjëse shqiptare duhet arritur urgjentisht lidhur me përgatitjen e listave të votuesve të përmirësuara në mënyrë të ndjeshme. Kjo ka qenë një prej kërkesave kryesore të OSBE/ODIHR-it dhe rekomandimet përkatëse mbeten ende për t'u zbatuar. Kur legjislacioni lë hapësirë për pasiguri lidhur me kompetencat, duhen kërkuar zgjidhjet më të efektshme, dhe jo thjesht më të lehtë – kjo lidhet me dhënien e asistencës kryetarëve të bashkive e komunave në administrimin e të dhënave të nevojshme për kthimin e listave paraprake të votuesve në përfundimtare.

Në mënyrë më të përgjithshme, unë dua të përsëris se një vullnet i mirë nga partitë politike që rezultojnë në zgjidhje të arsyeshme dhe konsensuale do të jetë çelësi i suksesit për zgjedhjet e ardhshme. Asnjë komision, institucion apo organ tjetër nuk mund të punojë siç duhet, nëse nuk udhëhiqet nga fryma e profesionalizmit dhe respektimi i shtetit të së drejtës. Forcat politike nuk duhet vetëm t'u përmbahen angazhimeve të tyre, por edhe të ushtrojnë ndikim aktiv tek përkrahësit dhe partnerët e tyre në këtë drejtim.